

## ***Ese:Krimet naziste ndaj Shqiptarëve***

Shënim:Burimi i informacionit që është përdorur për të shkruar esen është marë nga interneti dhe dokumentari "Nga Ferri në Ferr".




Stefan Kondu

*Punoi:Amela Gjana*  
*Klasa:11-10*



Beqir Xhepa



Ahmetër Simoni




Dulla Krutani



Gaqo Çomo



Vangjel Doni



Mehmet Agalli



Ahmet Çekaj

Nazistët,këto tiranë të tmerrshëm që shkatërruan shumë jetë njerëzish.Kjo ideologji politike që zgjati 12 vite(1933-1945).Plot 12 vite te tmerrshme dhe zije për Europën.Ashtu si çdo shtet tjetër i Europës edhe Shqipëria u pushtua nga Gjermania naziste më 8 shtator 1943(pas kapitullimit te Italisë fashiste).


Edhe pse një shtet i vogël e i coptuar si pasojë e pushtimeve të shteteve zullumqarë që nuk shihnin asgjë tjetër përveç pushtetit,ne përsëri përpiqeshim të qëndronim në këmbë në mënyrë që të mbronim Atëdhen dhe bukuritë e tij.Nazistët qëndruan ta mbanin Shqipërinë të gjunjëzuar për 1 vit(1943-1944).1 vit që për shqipëtarët dukej i pafundëm e që lotët e nënave nuk u shuan kurrë.

Dëshmitë se nazistët i torturuan njerëzisht mizorisht janë të shumta,po aq sa dëshmitë e lumturisë së tyre kur u liruan nga nazistët.Por jo të gjithë e kishin fatin që të gëzonin e të deheshin nga lumturia..Rreth 500 shqipëtarë u arrestuan gjatë Uracionit të tmerrshëm të dimrit(1943-1944)që i kaluan këta shqipëtarë nga ferri në ferr.

Sigurisht nga mizoria e tyre vetëm 23 shqipëtarë arritën të mbijetonin e të ktheheshin në Atëdhe.23 persona që shiheshin me krenari nga populli dhe që kane përshkruar torturat e tyre që nuk mund të imagjihoheshin nga mendjet njerëzore.Vlen për t'u përmendur edhe fakti që nga 23 të mbijetuar ne kemi 8 dëshmi të gjalla e me fakte në ditët e sotme.

Kur i dëgjon këto dëshmi të gjithve ne na rënqethet mishi,e pyesim veten se si u kanë mbijetuar atyre torturave ç'njerëzore,saqë mund të krahasohet shumë lehtë me luftën që bënë njerëzit në parahistori për mbijetesë e më keq?!

Një nga të mbijetuarit Beqir Xhepa i cili u arrestua ne moshën 14 vjecare ne Arbona tregon se në vagonin që të dërgonte në kampin e Mauthausenit ishte shumë ngushtë saqë nuk mund të merrje frymë,dhe përveç kësaj ato ishin të detyruar të qëndronin në këmbë përgjatë gjithë udhëtimit i cili zgjaste 1 javë.Në këtë 1 javë ku kishin të hanin vetëm 700 gram bukë e 2 lugë konserva dhe që pavarësisht kësaj vdiçën shumë veta.Më pas ai tregon se ishin vënë në rresht për 3 dhe kishin ecur 1 orë në këmbë duke ngjitur shkallët e kampit të cilët i krahasonin me shkallët e vdekjes dhe që i dërgonin në atë kamp të errët me parullë”Kush hyn,nuk del më”.Pasi kishin arritur në kamp të gjithë i kishin detyruar të vishnin një veshje me vija blu dhe të bardhë ku në kraharor kishin një numër të cilin ua skalitën edhe nepër duar duke ua djegur lëkurën në mënyrë që të mos e harronin kurrë ose përndryshe do të rriheshin me kamzhik...



Torturat nuk mbarojn me kaq ato ishin të përjetshme. Çdo muaj pushkatoheshin 10 veta, çdo ditë ashtu të kapur pas jetës zgjoheshin në orën 04:00 (në dimër në orën 05:15) dhe punonin 11 orë pa pushuar, si robotë, çdo ditë hanin vetëm për të mbajtur frymën gjallë, ishin aq të pashpresë sa që për të jetuar hanin bimë e gjethe...

Si për Shqipëtarët edhe për të tjerët krematoriumi ishte vendi më i tmerrshëm që ngjante me ferrin e që ka djegur pa mëshirë me miliona njerëz. Për shumë kohë të mbijetuarit rrinin me frikë se do të vdisnin nga uria, i ftohti i acartë në dimër, flakët e krematoriumit, breshëria e plumbave që binte si shi mbi to apo edhe nga helmimi i reve të frikshme të gazit që i mbulonte trupat e tyre siq mbulon mjegulla tokën...

Ja pra aq të shumta ishin torturat sa që të mbijetuarëve iu shiheshin kockat dhe as nënat e tyre nuk i njohën. Sado që të mundohemi të tregojmë vuajtjet e Shqipëtarëve nga nazistët, ne nuk do ja dalim kurrë sepse asnjë mendje njerëzore nuk i percepton dot. Prandaj na shërben historia, që jo vetëm të mësojmë për historinë e parëndësive tanë, por edhe të mësojmë nga gabimet e tyre e të mos lejojmë të ndodhin të tilla masakra njerëzore. Kjo sepse jeta e një njeriu ka vlerë sa e gjithë bota e asnjë nuk mund ta marrë atë si pasojë e përfitimeve të tij materiale.

